

**RELACION  
PËR  
PROJEKTVENDIMIN**

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 414, DATË 8.7.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE DHE KRITEREVE TË NDARJES DHE TË PËRDORIMIT TË FONDIT TË KUSHTËZUAR TË BUHETIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN CIVILE”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Qëllimi i këtij projektvendimi është që, përmes ndryshimit të shkronjës “ë”, të pikës 3.1, të vendimit nr. 414, datë 8.7.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, të rrisë hapësirën e vendimmarjes të bashkive në funksion të forcimit të kapaciteteve të tyre për përballimin e situatave emergjente të krijuara si pasojë e një fatkeqësie.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTË TË TJERA POLITIKE**

Projektvendimi nuk është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analistik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2023, për Ministrinë e Mbrotjes.

**III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Me miratimin e ligjit 45/2019, mbrojtja civile është kthyer në një prioritet për të gjithë organet e administratës publike. Ky ligj ka ndarë përgjegjësitë për këtë fushë në të gjithë nivelet si vertikale, ashtu edhe horizontale të administratës publike në shtetit tonë. Një faktor i rëndësishëm në mbrojtjen civile janë organet e vetëqeverisjes vendore, si baza e konstatimit të nevojave të komunitetit dhe si organe në paravijen e reagimit të shpejtë ndaj tyre, në rastin e një situate emergjente.

Në zbatim të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, fondi i dedikuar për mbrojtjen civile u kaloi bashkive në formën e një fondi të kushtëzuar nga buxheti i shtetit, në masën e 4 % të totalit të buxhetit vjetor të tyre dhe zbatimi i vendimit nr. 414, datë 8.7.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të

---

“Relacion shpjegues për projektvendimin “Për një ndryshim në vendimin nr. 414, datë 8.7.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”.

buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, u ka lënë hapësirë bashkive të veprojnë dhe të marrin të gjitha masat e duhura, në kuadër të reduktimit të riskut nga fatkeqësitetë dhe mbrojtjes civile.

Sidoqoftë, sipas vendimit nr. 414, datë 8.7.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, bashkitë mund të mbulojnë me fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile vetëm zërat e shpenzimit 604 (kompensim qytetarësh) dhe 602 (mallra dhe shërbime), duke kufizuar në këtë mënyrë hapësirën e vendimmarrjes të bashkive, në kuadër të reduktimit të riskut nga fatkeqësitetë dhe mbrojtjes civile, si edhe të forcimit të kapaciteteve të tyre për përballimin e situatave emergjente të krijuara si pasojë e një fatkeqësie.

Organet e vetëqeverisjes vendore janë baza e konstatimit të nevojave të komunitetit dhe, si të tilla, duhet të jenë në gjendje të përdorin me sa më shumë efektivitet fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile në funksion të nevojave specifike të territorit të tyre.

Për sa më sipër. Agjencia Kombëtare e Mbrotjes Civile propozon ndryshimin e shkronjës “e”, të pikës 3.1, të vendimit nr. 414, datë 8.7.2021, të Këshillit të Ministrave duke lejuar që foni i kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile të mund të përdoret edhe për zërin e shpenzimit 231 (investime kapitale).

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Hartimi i këtij projektvendimi bëhet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 65, të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”.

Projektvendimi është në përputhje me legjislacionin vendas dhe atë ndërkombëtar.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Ky projektvendim nuk është përafruar me *acquis* të Bashkimit Evropian.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKIT**

Në zbatim të ligjit nr. 45/2019, u hartua urdhri nr. 277, datë 06.12.2022, i drejtorit të përgjithshëm të AKMC-së “Për ngritjen e grupit të punës për ndryshimin e Vendimit nr. 414, datë 8.7.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”.

Grupi i punës mori në shqyrtim shkresën nr. 19618/5, datë 16.11.2022 “Mbi përdorimin e fondit të Emergjencave Civile”, të dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe vlerësoi se, në funksion të forcimit të kapaciteteve të bashkive për përballimin e situatave emergjente të

---

“Relacion shpjegues për projektvendimin “Për një ndryshim në vendimin nr. 414, datë 8.7.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”.

krijuara si pasojë e një fatkeqësie, do të ishte i dobishëm një ndryshim në pikën 3, të vendimit nr. 414, datë 8.7.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”.

Grupi i punës propozon që shkronja “ë”, e pikës 3.1, të ndryshojë, duke u mundësuar bashkive edhe blerjen e automjeteve për përdorim të veçantë, të cilësuara sipas germës “g”, të pikës 1, të nenit 54, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; e makinave teknologjike, të cilësuara sipas nenit 58, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe mjeteve rrugore të veçanta, të cilësuara sipas nenit 59, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të cilat përdoren për përballimin e situatave emergjente të krijuara si pasojë e një fatkeqësie.

Gjithashtu, në shkronjën “ë”, të pikës 3.1, përcaktohet se bashkitë mund të bëjnë shpenzime për blerje karburanti dhe pjesësh ndërrimi për automjete dhe makineri të cilat përdoren për përballimin e situatave emergjente të krijuara si pasojë e një fatkeqësie.

Ndryshimet e propozuara do të mundësojnë forcimin e kapaciteteve të bashkive për përballimin e situatave emergjente të krijuara si pasojë e një fatkeqësie dhe njëkohësisht, përcaktimi në këtë relacion i specifikimeve teknike të automjeteve dhe makinerive që mund të blihen, duke përdorur fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile, do të shërbejë për parandalimin e ndonjë abuzimi të mundshëm me këto fonde.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet se shkronja “ë”, e pikës 3.1, të vendimit nr. 414, datë 8.7.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ë) blerjen e automjeteve për përdorim të veçantë, makinave teknologjike dhe mjeteve rrugore të veçanta, të përcaktuara si të tilla sipas parashikimeve të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, të cilat përdoren për përballimin e situatave emergjente të krijuara si pasojë e një fatkeqësie, si edhe për shpenzime të kryera për blerje karburanti dhe pjesësh ndërrimi për automjete dhe makineri, të cilat përdoren për përballimin e situatave emergjente të krijuara si pasojë e një fatkeqësie”.

Ndërsa në pikën 2 përcaktohet se për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, bashkitë dhe prefektët e qarqeve.

## VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, bashkitë dhe prefektët e qarqeve, për zbatimin e këtij vendimi.

---

“Relacion shpjegues për projektvendimin “Për një ndryshim në vendimin nr. 414, datë 8.7.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Ky projektvendim është përgatitur nga Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

Projektvendimi u dërgua për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Brendshme dhe Këshillit Konsultativ Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

**Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Brendshme** janë shprehur parimisht dakord pa komente, mbi ndryshimin e parashikuar.

**Ministria e Financave** është shprehur parimisht dakord, me disa sugjerime të cilat janë argumentuar, si më poshtë vijon:

- *Në lidhje me pikën 2 të projektvendimit ku përcaktohet se “Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, vlerësojmë se ky parashikim është i panevojshëm dhe duhet të hiqet pasi është e përcaktuar në pikën 3 të vendimit nr.414/2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” – është reflektuar.*
- *Në kreun III të relacionit shoqërues është argumentuar se nga shumë bashki, si dhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë evidentuar disa problematika në lidhje me zërat e shpenzimeve që bashkitë mund të mbulojnë me fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile, dhe përrjedhojë është propozuar ndryshimi i shkronjës “ë”, të pikës 3.1 të vendimit nr. 414, datë 8.7.2021. Ndryshimi i propozuar është në përputhje me problematikat e konstatuara, por vlerësojmë se është i pjesshëm.*

*Lidhur me argumentin e dhënë sjellim në vëmendje se nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për fondin e kushtëzuar duhet të propozohen në buxhet produktet/projektet konkrete sipas pikës 3, të vendimit nr. 414, datë 8.7.2021, të Këshillit të Ministrave.*

*Në kushtet kur nga ana juaj është ndërmarrë nisma për ndryshimin e vendimit nr. 414, datë 8.7.2021, të Këshillit të Ministrave, sugjerojmë që ndryshimet e këtij vendimi të jenë më të zgjeruara, duke mos përfshirë vetëm aspektin e kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar, por gjithashtu edhe të procedurave, në mënyrë që foni i kushtëzuar i mbrojtjes civile për bashkitë të jetë i përdorshëm lehtësisht prej tyre për qëllimin e akorduar.*

*Konkretilisht lidhur me pikat 4 dhe 5 të vendimit nr.414 datë 8.7.2021 të Këshillit të Ministrave ku përcaktohet respektivisht “Në rast se konsiderohet e nevojshme të tejkalojen përqindjet e parashikuara nga pikat 3.1, 3.2 dhe 3.3, ky tejkalim duhet të autorizohet me një vendim të Këshillit Bashkiak” dhe “Përdorimi i fondeve, sipas përcaktimeve më sipër, miratohet me vendim të Këshillit Bashkiak” sugjerojmë të vlerësohet nëse kjo procedurë është e nevojshme,*

---

*“Relacion shpjegues për projektvendimin “Për një ndryshim në vendimin nr. 414, datë 8.7.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”.*

pasi bëhet fjalë për një fond të kushtëzuar që trajtohet në të njëjtën mënyrë si fondeve e pakushtëzuara apo të ardhurat e veta të bashkive. Nëse është i nevojshëm rialokimi i këtyre fondeve sipas nevojave të menjëherëshme në bazë të ndodhjes së emergjencave, a ndikon kjo procedurë në rritjen e kohës së vendimmarrjes dhe reagimit konkret - Për sa i përket procedurave për administrimin e fondeve të lëvruara, në zbatim të vendimit nr. 414, datë 8.7.2021, të Këshillit të Ministrave, sqarojmë se këto procedura nuk mund të ndryshojnë nga procedura standarde që përdoret nga njësítë e vetëqeverisjes vendore gjatë vendimmarrjes mbi çështje financiare, për arsyen se këshilli bashkiak duhet të miratojë projektbuxhetin për vitin në vijim dhe në këtë dokument duhet të pasqyrohen edhe shumat, pjesë e totalit të fondit të kushtëzuar që bashkia do të marrë në zbatim të VKM nr. 414, datë 8.7.2021, si edhe destinacionet e përdorimit të këtyre shumave, sipas përcaktimeve të pikës 3 të këtij vendimi.

Çdo destinacioni/zëri shpenzimi duhet t'i korrespondojë kodi përkatës 231, 602 ose 604 sipas nevojave specifike të secilës bashki dhe gjithashtu, duhet të saktësohet se ky zë shpenzimi është pjesë e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile.

Pasi të miratohet buxheti i bashkisë, totali i shumës së fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile i destinuar për bashkinë përkatëse, do të lëvrohet sipas kodeve/zërave të shpenzimit të parashikuara në buxhetin bashkiak.

Kjo procedurë do të sjellë shhangien e problematikave që u vunë re në zbatimin e VKM nr. 414, datë 8.7.2021, gjatë vitit 2022.

- *Gjithashtu lidhur më pikën 6 të vendimit nr. 414, datë 8.7.2021, të Këshillit të Ministrave ku përcaktohet se "Prefekti, pas konfirmimit të ligjshmërisë së vendimit të Këshillit Bashkiak, informon Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe Ministrinë e Mbrojtjes" nuk kuptohet ndikimi i kësaj procedure për vijimin e përdorimit të fondit. - Përcaktimet e kësaj pike janë në përputhje me përgjegjësitet kryesore të prefektit të qarkut, sipas përkufizimeve të nenit 8, të ligjit nr. 107/2016 "Për prefektin e qarkut".*

**Këshilli Konsultativ Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore** është shprehur parimisht dakord, me disa sugjerime të cilat janë argumentuar, si më poshtë vijon:

- *Pika 3.2 e VKM mbetet e pandryshuar, ndërkojë që projektvendimi shton përvëç marrjes me qira, edhe blerjen e automjeteve dhe pajisjeve të tjera duke limituar në këtë mënyrë përdorimin e fondit të kushtëzuar për prioritetet e tjera të parashikuara në pikën 3.1. Gjithashtu mungesa e parashikimit të specifikimeve teknike lidhur me blerjen e automjeteve apo makinave të tjera, mund të krijojë kushte për përdorimin abuziv të këtij fondi në bashki të ndryshme. Në këtë mënyrë, ndryshimi duhet të shihet i lidhur edhe me pikën 3.2 të VKM nr. 414/2021 – në kreu VI të relacionit janë përfshirë përcaktimet e këtyre mjeteve, përmos të lejuar përdorimin abuziv të këtyre fondeve. Ndryshimi i pikës 3.1, i VKM nr.*

---

"Relacion shpjegues për projektvendimin "Për një ndryshim në vendimin nr. 414, datë 8.7.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e procedurave dhe kriterieve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit, të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile".

**414, datë 8.7.2021, nuk duhet të shoqërohet me ndryshimin e pikës 3.2, kjo sepse pikë 3.1 nuk ndikon në përcaktimet e pikës 3.2, të vendimit 414, datë 8.7.2021.**

- *Të evidentohen qartësisht në relacion se cila është arsyja që ka sjellë nevojën për ndryshim dhe nuk evidentohen se cilat kanë qenë problematikat me të cilat janë hasur bashkitë lidhur me zbatimin e VKM nr. 414/2021 - Projektvendimi i paraqitur është i domosdoshëm për të plotësuar kërkesat e atyre bashkive që gjykojnë të dobishme pajisjen me mjete për përballimin e situatave emergjente dhe që nuk mund të përdorin fondin e kushtëzuar për mbrojtjen civile, sepse kjo mundësi nuk parashikohej në VKM nr. 414. Disa bashki, bazuar në nevojat e tyre, kanë kërkuar të përdorin fondin e kushtëzuar për blerje mjetesh për përballimin e situatave emergjente dhe për të plotësuar këto kërkesa dhe gjithashtu për të mos kufizuar vendimmarrjen e organeve të vetëqeverisjes vendore, është parë nevoja e ndërhyrjes në vendimin nr. 414, datë 8.7.2021. Bashkitë do të kenë një mundësi më shumë për të plotësuar nevojat e tyre për përballimin e situatave emergjente të krijuara nga fatkeqësítë dhe është përgjegjësia e tyre si do të shpenzojnë këto fonde dhe si do të prioritarizojnë nevojat e tyre specifike. Krijimi i kushteve normative që bashkitë të përdorin fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile për blerjen e mjeteve, të cilat do të përdoren për përballimin e situatave emergjente të krijuara si pasojë e një fatkeqësie, nuk nënkupton “detyrimin” që bashkitë të përdorin këto fonde për blerjen e mjeteve.*
- *Të parashikohet me akt ligjor specifikimet teknike për blerjen e makinave, gjë që jo vetëm nuk është shpjeguar në relacion, por nga ana tjetër duhet të bëhet me akt ligjor dhe jo përmes relacionit. – specifikimet teknike janë ripunuar edhe në projektvendim edhe janë sqaruar në relacion.*

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Efektet financiare të këtij projektvendimi do të përballohen nga buxheti i miratuar për fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile.



---

“Relacion shpjegues për projektvendimin “Për një ndryshim në vendimin nr. 414, datë 8.7.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”.